



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, e Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008) dhe nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01.nr.110-392, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 31.1.2025, merr këtë

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e përfaqësuesve të lagjes “Kodra e Diellit II” për themelimin e Komisionit për vlerësimin dhe shqyrtimin e Aktvendimit mbi eksproprijim, nr. 07. nr. 465-25/85, të datës 8 korrik 1985.
2. Komisioni ka këtë përbërje:
 - 2.1. Ermal Osmani, përfaqësuesi i grupit të asamblastëve të LVV-së;
 - 2.2. Driton Rukiqi, përfaqësuesi i grupit të asamblastëve të LDK-së;
 - 2.3. Endrit Gashi, përfaqësuesi i grupit të asamblastëve të AAK-së;
 - 2.4. Gëzim Mehmeti, përfaqësuesi i grupit të asamblastëve të AKR-së;
 - 2.5. tre përfaqësues nga ekzekutivi, një nga Drejtoria e Pronave, një nga Drejtoria e Kadastrit dhe një nga Zyra ligjore, të cilët caktohen me vendim të Kryetarit.
3. Komisioni do të shqyrtojë të gjithë dokumentacionin lidhur me aktvendimin për eksproprijim sipas pikës 1. të këtij vendimi, dhe duke marr për bazë gjendjen juridike t’i rekomandojë Kuvendit të Kryeqytetit që të marrë vendim meritor.
4. Komisioni gjatë punës së vet, duhet të bashkëpunojë ngushtë me parashtruesit e kërkesës, si dhe të gjitha drejtoritë e Komunës duhet t’u përgjigjen kërkesave të Komisionit.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-020/04-17860/25, më 4.2.2025

KRYESUES I KUVENDIT
Fehmi Kupina

